



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 4

2002

Shkurt

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8856 datë 7.2.2002	Për ratifikimin e “Konventës nr.154 “Bisedimet kolektive, 1981” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës” .....	73
Ligj nr.8857 datë 7.2.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, ndryshuar me ligjin nr.8394, datë 2.9.1998 .....	77
Dekret nr. 3249 datë 1.2.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare .....	78
Dekret nr.3254 datë 8.2.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare .....	79
Vendim i Kuvendit nr. 17, datë 14.2.2002	Për disa ndryshime e plotësime në vendimin nr.3, datë 17.9.2001 "Për komisionet e përhershme të kuvendit dhe përbërjen e kryesive të tyre" .....	80
Vendim i Kuvendit nr.18, datë 21.2.2002	Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave .....	81
Vendim i KM nr.43, datë 7.2.2002	Për pagesën e kandidatëve që punësohen në Shërbimin Informativ Shtetëror .....	82

Vendim i KM nr.44, datë 7.2.2002	Për lejimin e përdorimit të procedurës së prokurimit "Kërkesë për kuotim" për auditimin e projekteve të financuara nga Banka Botërore dhe për grantet .....	83
Vendim i KM nr.46, datë 7.2.2002	Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e qendrave të pritjes dhe të trajtimit të përkohshëm të të huajve joazilkërkues"	84
Vendim i GJK nr.213, datë 16.11.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, marrë në Dhomën e Këshillimit.....	89
Vendim i GJK nr.8, datë 23.1.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.410, datë 25.4.2001 e nr.3, datë 8.10.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë .....	91
Vendim i GJK nr.18, datë 1.2.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.607, datë 14.6.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	93
Vendim i GJK nr.20, datë 8.2.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.351, datë 5.10.1999 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr.1508, datë 22.12.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.B-3, datë 24.7.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	97

**LIGJ**  
**Nr. 8856, datë 7.2.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.154 “BISEDIMET KOLEKTIVE, 1981” TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.154 “Bisedimet kolektive, 1981” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3255, datë 11.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

**KONVENTA NR.154**  
**KONVENTA LIDHUR ME NXITJEN E BISEDIMEVE KOLEKTIVE**

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbledhur në sesionin e saj të gjashtëdhjetë e shtatë më 3 qershor 1981, dhe

Duke ritheksuar pjesën e Deklaratës së Filadelfias që njeh "detyrimin solemn të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të nxitur ndërmjet vendeve të ndryshme zbatimin e programeve botërore, që synojnë njohjen efektive të së drejtës së negociatave kolektive", dhe duke shënuar se ky parim është "plotësisht i zbatueshëm ndaj të gjithë njerëzve kudo që të jenë", dhe

Duke marrë parasysh rëndësinë kapitale të standardeve ekzistuese ndërkombëtare që përmbajnë Konventa Liria e Shoqatave dhe Mbrojtja e të Drejtës së Organizimit, 1948, Konventa e Drejta e Organizimit dhe Negociatave Kolektive, 1949, Rekomandimi Marrëveshjet Kolektive, 151, Rekomandimi Pajtimi dhe Arbitrimi Vullnetar, 1951, Konventa dhe Rekomandimi Marrëdhëniet e Punës (Shërbimi Publik), 1978 dhe Konventa dhe Rekomandimi Administrata e Punës, 1978 dhe

Duke konsideruar se është e dëshirueshme që të bëhen përpjekje më të mëdha për arritjen e objektivave të këtyre standardeve dhe, veçanërisht, të parimeve të përgjithshme të shprehura në nenin 4 të Konventës e Drejta e Organizimit dhe Bisedimeve Kolektive, 1949 dhe në paragrafin 1 të Rekomandimit, 1951, Marrëveshjet Kolektive, dhe

Duke konsideruar, për pasojë, se këto standarde duhet të plotësohen me masat e përshtatshme, në përputhje me to dhe që synojnë nxitjen e negociatave kolektive të lira dhe vullnetare, dhe

Pasi vendosi për miratimin e disa propozimeve lidhur me nxitjen e bisedimeve kolektive, e cila është pika e katërt e rendit të ditës së sesionit, dhe

Pasi vendosi që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare, miraton këtë ditë të nëntëmbëdhjetë të qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një, konventën e mëposhtme, e cila mund të quhet Konventa Bisedimet Kolektive, 1981:

## PJESA I. FUSHA DHE PËRKUFIZIMET

### Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet në të gjitha degët e veprimtarisë ekonomike.
2. Masa, në të cilën garancitë e parashikuara në këtë Konventë zbatohen ndaj Forcave të Armatosura dhe Policisë, mund të përcaktohet nga ligjet ose rregullat e brendshme ose nga praktika e vendit.
3. Rregullat e veçanta për zbatimin e kësaj Konvente në shërbimin publik mund të përcaktohen nga ligjet ose rregullat e brendshme ose nga praktika e vendit.

### Neni 2

Në kuptim të kësaj Konvente, termi "bisedime kolektive" nënkupton të gjitha bisedimet që zhvillohen midis një punëdhënësi, një grupi punëdhënësish ose një apo më shumë organizatave të punëdhënësve, në njërin anë, dhe një apo më shumë organizatave të punonjësve, nga ana tjetër, për:

- a) përcaktimin e kushteve të punës dhe termat e punësimit; dhe/ose
- b) rregullimin e marrëdhënieve midis punëdhënësve dhe punonjësve; dhe/ose
- c) rregullimin e marrëdhënieve midis punëdhënësve ose organizatave të tyre; dhe një ose
- d) disa organizatave të punonjësve.

### Neni 3

1. Kur legjislacioni ose praktika e brendshme njeh ekzistencën e përfaqësuesve të punonjësve, siç përcaktohet në nenin 3 nënparagrafi (b) i Konventës, përfaqësuesit e punonjësve, 1971, legjislacioni ose praktika e brendshme mund të përcaktojë masën në të cilën termi "bisedime kolektive" duhet të shtrihet, për qëllimin e kësaj Konvente, në negociatat me këta përfaqësues.

2. Kur, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, termi "bisedime kolektive" përfshijnë, gjithashtu, bisedimet me përfaqësuesit e punonjësve të përmendur në atë paragraf, duhet të merren masat e përshtatshme, në çdo rast që është e nevojshme, për të siguruar se ekzistenca e këtyre përfaqësuesve nuk është shfrytëzuar për të minuar pozitën e organizatave të interesuara të punonjësve.

## PJESA II. METODAT E ZBATIMIT

### Neni 4

Dispozitat e kësaj Konvente duhet, për sa ato nuk janë bërë efektive nëpërmjet kontratave kolektive, vendimeve të arbitrimit ose me anën e një mënyre tjetër që është në përputhje me praktikën e vendit, të bëhen efektive nëpërmjet ligjeve ose rregullave të brendshme.

## PJESA III. NXITJA E BISEDIMEVE KOLEKTIVE

### Neni 5

1. Duhet të merren masa, në përputhje me kushtet e vendit, për nxitjen e bisedimeve kolektive.

2. Qëllimi i masave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë:
- a) negociatat kolektive duhet të bëhen të mundura për të gjithë punëdhënësit dhe të gjitha grupet e punonjësve në degët e veprimtarisë që mbulojnë nga kjo Konventë;
  - b) bisedimet kolektive duhet të shtrihen progresivisht në të gjitha çështjet e mbuluara nga nënparagrafët a, b, dhe c të nenit 2 të kësaj Konvente;
  - c) inkurajimi i caktimit të rregullave procedurale në marrëveshje midis organizatave të punëdhënëseve dhe punonjësve;
  - d) bisedimet kolektive nuk duhet të pengohen nga mungesa e dispozitave që rregullojnë procedurën e tyre ose nga pasaktësia ose papërshtatshmëria e këtyre rregullave;
  - e) organet dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës duhet të jenë të tilla që të ndihmojnë nxitjen e bisedimeve kolektive.

#### Neni 6

Dispozitat e kësaj Konvente nuk ndalojnë veprimin e sistemeve të marrëdhënieve profesionale, në të cilat bisedimet kolektive zhvillohen në kuadrin e mekanizmit ose insitucioneve të pajtimit dhe/ose arbitrimin, mekanizëm ose institucione në të cilat Palët në bisedimet kolektive marrin pjesë vullnetarisht.

#### Neni 7

Masat që merren nga autoritetet publike për të nxitur bisedimet kolektive duhet të jenë objekt i konsultimeve paraprake dhe, kur është e mundur, i marrëveshjeve midis autoriteteve publike dhe organizatave të punëdhënëseve dhe të punonjësve.

#### Neni 8

Masat e marra me qëllim që të nxisin bisedimet kolektive nuk duhet të kuptohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të pengojnë lirinë e bisedimeve kolektive.

### PJESA IV. DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 9

Kjo Konventë nuk ndryshon asnjë konventë ose rekomandim që është në fuqi.

#### Neni 10

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

#### Neni 11

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar tek Drejtori i Përgjithshëm.
2. Ajo hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimet e dy Anëtarëve janë regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm.
3. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i tij.

## Neni 12

1. Anëtari që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pas kalimit të dhjetë vjetëve nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi për herë të parë, me anën e një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Ky denoncim hyn në fuqi pas një viti nga data e regjistrimit të tij.

2. Çdo Anëtar, që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen brenda një viti nga data e mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin e mësipërm, është i lidhur me detyrimet e Konventës edhe për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj mund të denoncojë këtë Konventë në mbarimin e çdo periudhe dhjetëvjeçare, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen.

## Neni 13

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet të njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për komunikimin e regjistrimit të ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'iu njoftojë Anëtarëve të Organizatës datën në të cilën ajo hyn në fuqi.

## Neni 14

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha veçoritë e ratifikimeve dhe akteve të denoncimit të regjistruara tek ai, në përputhje me dispozitat e neneve të mësipërme.

## Neni 15

Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet, sa herë që e gjykon të nevojshme, t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe të shqyrtojë nevojën e vendosjes në rendin e ditës së Konferencës të çështjes së ndryshimit të saj të pjesshëm apo të plotë.

## Neni 16

1. Kur Konferenca miraton një konventë të re që ndryshon pjesërisht apo plotësisht këtë Konventë, përveç kur konventa e re parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një Anëtar i Konventës së re prezumon ipso jure denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 12, nëse dhe kur konventa e re hyn në fuqi;

b) nga data në të cilën konventa e re hyn në fuqi kjo Konventë pushon së qeni e hapur për ratifikim nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale, në çdo rast, për ata Anëtarë që e kanë ratifikuar atë, por që nuk kanë ratifikuar konventën e re që e ndryshon atë.

## Neni 17

Tekstet anglisht dhe frëngjisht të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.

**LIGJ**  
**Nr. 8857, datë 7.2.2002**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7986, DATË 13.9.1995 “PËR  
INSPEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS”, NDRYSHUAR ME LIGJIN  
NR.8394, DATË 2.9.1998**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, ndryshuar me ligjin nr.8394, datë 2.9.1998, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 27 ndryshon si më poshtë:

“Neni 27

**Procedura dhe sanksione**

1. Për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës, inspektori i punës vendos gjobë ndaj kundërvajtësve deri në vlerën e pesëdhjetëfishit të pagës minimale.

2. Kundërshtimi dhe pengimi i inspektorëve në ushtrimin e detyrës përbën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë.

3. Kur shkelja përbën vepër penale, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

4. Kundër vendimit të inspektorit të punës mund të bëhet ankim, pranë Inspektorit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Inspektori i Përgjithshëm shprehhet dhe nxjerr vendim për ankimin brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të ankesës.

Kundër vendimit të Inspektorit të Përgjithshëm mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë ku ka ndodhur kundërvajtja, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Vendimet e formës së prerë, të marra nga Inspektorati i Punës, janë tituj ekzekutivë dhe kur nuk zbatohen vullnetarisht nga kundërvajtësit, ekzekutohen nga zyrat e përmbarimit.”.

Neni 2

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

1. Kur gjobat e vëna nga Inspektorati i Punës nuk ekzekutohen vullnetarisht, zyra e përmbarimit vë në sekuestrim një pjesë të pasurisë së kundërvajtësit, sa vlera e gjobës për 6 muaj.

2. Kur pas këtij afati nuk ekzekutohet vendimi, bëhet konfiskimi i pasurisë në vlerën e gjobës.”.

Neni 3

Nenet 25, 26 dhe 26/1 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, ndryshuar me ligjin nr.8394, datë 2.9.1998, shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3256, datë 11.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**DEKRET  
Nr. 3249, datë 1.2.2002**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Qerim Ilias Pashollari
2. Samanta Qerim Pashollari
3. Anila Hikmet Lasku (Fekollari)
4. Sven Ylli Lasku
5. Gina Maria Ylli Lasku
6. Kasëm (Kasem) Ramiz Hoxha
7. Elda Fatmir Sorra
8. Kujtim Qazim Dapi
9. Andi Kujtim Dapi
10. Arenc Beniamin Lohja
11. Naim Hariz Hila
12. Arjan Dari Saliu
13. Sara Arjan Saliu
14. Klara Arjan Saliu
15. Mimoza Ali Saliu (Hasani)
16. Alban Irfan Strobel (Rabo)
17. Luan Islam Dorzi
18. Denes Luan Dorzi
19. Andreas Luan Dorzi
20. Klementina Ramadam Dorzi (Lumi)
21. Bojana Luan Dorzi
22. Avni Ferik Hoxha
23. Gazmir Ethem Schnell (Mata)
24. Edlira Ismail Topi
25. Florinda Sabajdin Treinen (Jahja)
26. Arben Xhafer Duro

27. Angela Arben Duro
28. Miranda Mustafa Duro (Lapi)
29. Irini Sotir Garuli (Filito)
30. Jolanda Lekë Doda
31. Ina Zef Dedushi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**DEKRET**  
**Nr. 3254, datë 8.2.2002**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arben Abedin Sejko
2. Samir Maliq Celufaj
3. Aulona Hasan Baliu (Xhuti)
4. Dea Abdulla Baliu
5. Vjollca Hasan Dautaj (Çeço)
6. Muharrem Rahim Dautaj
7. Fredi Muhamed Shehi
8. Ariel Agron Alikaj
9. Alfred Rexhep Asllanaj
10. Arben Sadil Seferi
11. Enver Nuh Kazazi
12. Ergys Hamdi Çullhaj (Cullhaj)
13. Gëzim Telha Lenja
14. Gisela Gëzim Lenja
15. Entela Fredi Lenja (Mariani)
16. Mariola Shpëtim Ameti (Dani)
17. Sonila Sazan Kloppenborg (Sulaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**VENDIM**  
**Nr. 17, datë 14.2.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME E PLOTËSIME NË VENDIMIN NR.3, DATË 17.9.2001 "PËR  
KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT DHE PËRBËRJEN E KRYESIVE TË  
TYRE"**

Në mbështetje të neneve 23, 24, 27 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, si dhe duke u mbështetur në marrëveshjen e kryesive të grupeve parlamentare,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.3, datë 17.9.2001 "Për komisionet e përhershme të Kuvendit dhe përbërjen e kryesive të tyre" bëhen këto ndryshime dhe plotësime:

- I. Në komisionet e përhershme të Kuvendit bëhen ndryshimet si më poshtë:
  1. Komisioni i Përhershëm për Politikën e Jashtme bëhet nga 9 në 11 anëtarë.
  2. Komisioni i Përhershëm për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë bëhet nga 9 në 11 anëtarë.
  3. Komisioni i Përhershëm për Bujqësinë dhe Ushqimin bëhet nga 9 në 11 anëtarë.
  4. Komisioni i Përhershëm për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet bëhet nga 9 në 11 anëtarë.
  5. Komisioni i Përhershëm i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit bëhet nga 9 në 7 anëtarë.
  6. Komisioni i Përhershëm i Rendit dhe SHISH-it bëhet nga 9 në 11 anëtarë.
- II. Në komisionet e përhershme të Kuvendit bëhen plotësimet si më poshtë:
  1. Deputetët Spartak Ngjela, Pal Dajçi, Arjan Starova, Fatos Beja dhe Sali Shehu caktohen në Komisionin e Përhershëm për Çështjet Kushtetuese e Ligjore.
  2. Deputetët Pjetër Arbnori dhe Shpëtim Roqi caktohen në Komisionin e Përhershëm për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet.
  3. Deputetët Besnik Mustafaj, Fatmir Mediu, Lublin Dilja, Eqerem Spahiu dhe Mustafa Xhani caktohen në Komisionin e Përhershëm për Politikën e Jashtme.
  4. Deputetët Ridvan Bode, Gjovalin Bzheta, Robert Çeku dhe Sadedin Balla caktohen në Komisionin e Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin.
  5. Deputetët Astrit Bushati, Pëllumb Berisha e Uran Metko caktohen në Komisionin e Përhershëm të Mbrojtjes.
  6. Deputetët Shaban Memia, Ndriçim Babazi, Aleksandër Garuli, Alfred Çako dhe Marko Bello caktohen në Komisionin e Përhershëm të Rendit dhe SHISH-it.
  7. Deputetët Edi Paloka dhe Vili Minarolli caktohen në Komisionin e Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik.
  8. Deputetët Marjeta Pronjari, Azgan Haklaj, Teodor Laço dhe Durim Hushi caktohen në Komisionin e Përhershëm të Punës dhe të Çështjeve Sociale.
  9. Deputetët Jemin Gjana, Bamir Topi, Maksim Begeja, Valentin Palaj dhe Ndue Preka caktohen në Komisionin e Përhershëm për Bujqësinë dhe Ushqimin.
  10. Deputetët Ilir Bano, Dilaver Qesja, Muhamet Ukperaj, Gani Hoxha dhe Gaço Apostoli caktohen në Komisionin e Përhershëm për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë.
  11. Deputetët Neritan Alibali, Bardhyl Londo, Luigj Gjoka e Limoz Dizdari caktohen në Komisionin e Përhershëm për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet.

12. Deputetët Ferit Hoti dhe Ibrahim Bruka caktohen në Komisionin e Përhershëm të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

13. Deputetët Sokol Oldashi, Zef Gjoka dhe Ethem Fejzollari caktohen në Komisionin e Përhershëm të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**  
**Namik Dokle**

**VENDIM**  
**Nr. 18, datë 21.2.2002**

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE PROGRAMIT POLITIK**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të neneve 96, 97, 98 dhe 78 të Kushtetutës, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.3259, datë 15.2.2002 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Miratohet përbërja e Këshillit të Ministrave si më poshtë:

1. Pandeli Majko	Kryeministër
2. Skënder Gjinushi	Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale
3. Arta Dade	Ministër i Punëve të Jashtme
4. Stefan Çipa	Ministër i Rendit Publik
5. Luan Rama	Ministër i Mbrojtjes
6. Kastriot Islami	Ministër i Financave
7. Spiro Peçi	Ministër i Drejtësisë
8. Et'hem Ruka	Ministër i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit
9. Viktor Doda	Ministër i Industrisë dhe Energjetikës
10. Fatmir Xhafa	Ministër i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
11. Maqo Lakrori	Ministër i Transportit dhe Telekomunikacioneve
12. Luan Memushi	Ministër i Arsimit dhe Shkencës
13. Mustafa Xhani	Ministër i Shëndetësisë
14. Ermelinda Meksi	Ministër i Ekonomisë
15. Agron Duka	Ministër i Bujqësisë
16. Agron Tato	Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
17. Lufter Xhuvëli	Ministër i Mjedisit
18. Marko Bello	Ministër Shteti për Integrimin
19. Ndre Legisi	Ministër Shteti pranë Kryeministrit

II. Miratohet Programi Politik i Këshillit të Ministrave sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**  
**Namik Dokle**

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 7.2.2002**

**PËR PAGESËN E KANDIDATËVE QË PUNËSOHEN NË SHËRBIMIN INFORMATIV SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kandidatët që punësohen në Shërbimin Informativ Shtetëror, pas përfundimit të shkollës së lartë, të paguhen për kohën që vazhdojnë kursin e kualifikimit pranë Institutit të Shërbimit Informativ Shtetëror me pagën minimale të oficerit të SHISH-it.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Shërbimin Informativ Shtetëror.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2001.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 44, datë 7.2.2002**

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT "KËRKESË PËR KUOTIM" PËR AUDITIMIN E PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA BANKA BOTËRORE DHE PËR GRANTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995; nr.8074, datë 22.2.1996; nr.8112, datë 28.3.1996; nr.8767, datë 5.4.2001 dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Lejimin e Ministrisë së Financave që, me fondin e vet limit prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, të përdorë procedurën e prokurimit "Kërkesë për kuotim", me afat të përshpejtuar jo më pak se 15 ditë, për auditimin e projekteve të financuara nga Banka Botërore dhe për grantet, me shoqëritë e mëposhtme:

- a) Deloitte and touch  
Shqipëri
- b) PricEË Waterhouse coppers  
Itali
- c) Kpmg Albania sh.p.k  
Shqipëri
- ç) Arthur Andersen  
Britani e Madhe

- d) Ernest & Yang  
Greqi  
2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 46, datë 7.2.2002**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR FUNKSIONIMIN E QENDRAVE TË PRITJES  
DHE TË TRAJTIMIT TË PËRKOHSHËM TË TË HUAJVE JOAZILKËRKUES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 "Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rregullore "Për funksionimin e qendrave të pritjes dhe të trajtimit të përkohshëm të të huajve joazilkërkues".
2. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e kësaj rregulloreje.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**RREGULLORE**  
**PËR FUNKSIONIMIN E QENDRAVE TË PRITJES DHE TË TRAJTIMIT TË PËRKOHSHËM  
TË TË HUAJVE JOAZILKËRKUES**

**KREU I**

Neni 1  
**Objekti**

Kjo Rregullore përcakton rregullat e brendshme të qendrave të pritjes dhe të trajtimit të përkohshëm të të huajve joazilkërkues (shkurt Qendra) për të siguruar administrimin e tyre korrekt dhe mbrojtjen e ndihmën për shtetasit e huaj, që gjenden në Qendër.

Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga qendrat, të cilat janë në varësinë e Ministrisë së Rendit Publik dhe nuk i referohen, në asnjë mënyrë, Qendrës së pritjes për azilkërkuesit, në varësi të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, përmes Zyrës për Refugjatët.

Neni 2  
**Roli i Qendrës**

Si pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit, e ngritur për sigurimin e shtetasve të huaj, Qendra realizon:

1. ndihmën e parë dhe asistencën;

2. respektimin e traditave, të kulturës dhe besimit fetar;
3. garantimin e sigurisë së shtetasve, krijimin e një atmosfere të ngrohtë e harmonike ndërmjet bashkësive dhe integrimin në jetën e bashkësisë së kësaj Qendre;
4. ruajtjen e të dhënave personale për çdo shtetas të huaj;
5. përgatitjen e largimit të shtetasve të huaj për në vendet e origjinës.

### Neni 3

#### **Menaxhimi i Qendrës**

a) Ministria e Rendit Publik do të sigurojë bashkëveprimin e nevojshëm me organizmat ndërkombëtarë, të vendosur në vendin tonë, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Qendrës dhe sigurimin e të drejtave të shtetasve të huaj në to.

b) Drejtoria Qendrore e Policisë Kufitare është përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëfunksionimin e Qendrës.

c) Drejtoria Qendrore e Policisë Kufitare dhe strukturat e tjera të Policisë së Shtetit do të mbikëqyrin veprimtarinë e Qendrës dhe do të sigurojnë respektimin e rregullave nga shtetasit e huaj.

## KREU II

### STANDARDET E TRAJTIMIT TË SHTETASVE NË QENDRA

### Neni 4

#### **Marrja e vendimit për trajtimin në qendra**

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit miraton vendimet e Drejtorit të Policisë Kufitare për trajtimin e të huajve në qendra, sipas ligjit "Për të huajt" dhe sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 "Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë".

### Neni 5

#### **Njohja me vendimin e trajtimit**

Shtetasit e huaj, të cilëve u komunikohet vendimi për trajtimin në qendra, njihen me të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në këtë rregullore për përjashtimin e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe rikthimin e tyre në shtetet e origjinës.

Në aktin e qëndrimit në Qendrën e trajtimit, të huajve u komunikohet se, në rast se vlerësimi i tyre përfshihet në nenet 4 dhe 5 të ligjit "Për të huajt", u hiqet masa e trajtimit dhe se do të rikthehen, menjëherë, në vendin e origjinës, me ndihmën e forcave të policisë.

### Neni 6

#### **Pjesëmarrja në shërbime dhe respektimi i rregullave në qendra**

Të gjithë shtetasit e huaj në qendra, në mënyrë të barabartë dhe pa u diskriminuar, përfitojnë shërbimet e siguruar për ta, marrin pjesë në përpjekjet e përbashkëta për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe janë të detyruar të respektojnë rregullat e vendosura.

### Neni 7

#### **Vendet e trajtimit**

Trajtimi i të huajve bëhet vetëm në qendra të përcaktuara sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje ose pranë vendeve të mjekimit. Drejtori i Qendrës merr masa për sigurimin e shoqërimit dhe ruajtjen e tyre në vendin e mjekimit.

## Neni 8

### **Të drejtat e shtetasve në qendra dhe detyrimi i organit policor**

1. Në rastet kur rrezikohet jeta e një familjari të shtetasit të trajtuar në Shqipëri apo për motive të tjera, të rënda, me propozimin e Drejtorit të Qendrës, gjyqtari, i cili ka në proces shtetasin, mund ta autorizojë të huajin të largohet nga Qendra për një periudhë të nevojshme kohe të kufizuar, duke njoftuar Drejtorin e Qendrës që të sigurojë shoqërimin e të huajit.

2. Drejtuesit e Qendrës dhe shtetasit e mbajtur në Qendër kujdesen që në Qendër të ndiqen liria e besimit fetar dhe praktimi i tij, brenda kufijve të parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

3. Për të lehtësuar komunikimin me shtetasit e huaj që trajtohen në Qendër caktohet një përkthyes i gatshëm në çdo kohë.

4. Kur shtetasi i huaj ankohet në gjykatë, një përfaqësues i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit merr pjesë si palë në ankimimin e tij.

5. Drejtori i Policisë Kufitare siguron, nëpërmjet organizmave që ka në varësi, një fletëpalosje që përmban të drejtat dhe detyrimet e shtetasve të huaj në Qendër, e cila i shpërndahet çdo shtetasi të huaj.

6. Autoritetet policore në Qendër mund të marrin nga të huajt që mbahen atje kërkesat për azil. Kërkesa për azil nënkupton çdo lloj kërkesë për azil, e bërë kjo gojarisht, me shkrim apo me gjeste.

7. Drejtoria e Qendrës garanton kontaktin e të huajve të mbajtur në Qendër me Zyrën për Refugjatët dhe/ose me UNHCR-në, për ata që nuk janë intervistuar për kërkesat e tyre për azil.

8. Të huajt që kërkojnë azil kalojnë më pas nën përgjegjësinë e Zyrës për Refugjatët, e cila i transferon ata brenda 48 orësh nga çasti i intervistimit në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve.

9. Azilkërkuesi, të cilit në shkallë të fundit i është refuzuar dhënia e azilit në Republikën e Shqipërisë, drejtohet në Policinë e Shtetit, nëpërmjet Zyrës për Refugjatët, për trajtimin në këtë Qendër.

10. Drejtoria e Qendrës merr masat e nevojshme për sigurimin e mjediseve të brendshme dhe rendit publik në Qendër, përfshi ato të identifikimit të personave, për ndalimin e largimit të paligjshëm të të huajve. Kur cenohet rendi në Qendër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë merr masat e nevojshme për rivendosjen e qetësisë.

11. Për kryerjen e veprimtarisë, autoriteteve konsullore në mjediset e Qendrës u vihet në dispozicion një mjedis i përshtatshëm. Autoriteti policor vendor siguron bashkëpunimin me përfaqësuesit konsullorë, deri në plotësimin dhe lëshimin e dokumenteve të nevojshme shtetasve të trajtuar. Shpenzimet përballohen nga Ministria e Rendit Publik e Shqipërisë.

12. Shtetasve të huaj që kanë pjesëtarë të familjes u krijohen lehtësi të mundshme, si dhomë e veçantë për fjetje.

13. Shtetasve të huaj të trajtuar u sigurohet qëndrimi në mjedisin e jashtëm për shplodhje dhe argëtim deri në 4 orë në ditë, sipas programit dhe planifikimit të bërë nga menaxheri i Qendrës.

## KREU III SHËRBIMET

### Neni 9

#### **Pagesat për trajtim**

Në Qendër, pagesat e ushqimit, higjienës, fjetjes dhe transportit, përgjegjësisht, mbulohen nga Ministria e Rendit Publik.

### Neni 10

#### **Asistenca ushqimore**

a. Kjo asistencë sigurohet në mënyrë të barabartë për çdo shtetas të huaj, në përputhje me standardet kombëtare.

- b. Ushqimi shpërndahet tri herë në ditë, sipas një orari të përcaktuar.
- c. Personave me rekomandim nga mjeku u sigurohet trajtim i veçantë.

#### Neni 11

#### **Asistenca sociale dhe juridike**

- a) Asistenca sociale dhe juridike sigurohet periodikisht dhe në mënyrë të përshtatshme, kur është e nevojshme.
- b) Këshillim i rregullt dhe i përshtatshëm sigurohet, në rast nevoje, për çdo shtetas. Nevojat vlerësohen nga një punonjës social me përvojë pune.
- c) Për problemet personale të shtetasve respektohet konfidencialiteti.
- ç) Përkthyesit, avokatit, mjekut, zyrtarëve të Zyrës së Refugjatit, zyrtarëve të UNHCR-së, pjesëtarëve të trupit diplomatik, konsullatës, punonjësve të shërbimeve sociale dhe komitetit që merret me të huajt u krijohen të gjitha mundësitë e takimit të lirë me të huajt e mbajtur në Qendër.
- d) Drejtoria e Qendrës merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që gratë dhe fëmijët të mbahen veças nga burrat, përveç rasteve kur janë një familje. Të miturve të pashoqëruar u sigurohet kujdesi i nevojshëm, siç përcaktohet në Konventën "Për të drejtat e fëmijëve".

#### Neni 12

#### **Shërbimi shëndetësor**

- a) Ky shërbim realizohet në Qendër në mjedise të posaçme e të përhershme.
- b) Para se të hyjnë në Qendër, shtetasve të huaj u bëhet kontrolli shëndetësor.
- c) Sigurohet transport 24 orësh për në spital, sa herë të jetë i nevojshëm.
- ç) Shërbimi mjekësor, kur është i nevojshëm, sigurohet nga ambulanca/spitali shtetëror në zonën ku është vendosur Qendra.
- d) Në rastet kur është i nevojshëm një shtrim në spital, i huaji mbikëqyret nga personeli i policisë.
- d) Evakuimi mjekësor vlerësohet nga një personel i specializuar, mjekësor, shtetëror.
- e) Evakuimi mjekësor nuk lejohet të neglizhohet ose të parandalohet nga asnjë autoritet dhe kryhet sipas rregullave shqiptare.
- ë) Kujdesi i veçantë u kushtohet shtetasve me probleme të rënda shëndetësore.
- f) Veprimtaritë sportive dhe rigjeneruese organizohen vazhdimisht.

#### Neni 13

#### **Vizitat, komunikimi me botën e jashtme**

1. Brenda limitit të paracaktuar nga rregullat e sigurisë, të huajt mund të presin vizitat nga pjesëtarë të familjes, avokati, përfaqësuesi i kultit, personeli i përfaqësive diplomatike apo konsullore, nga zyrtarë të UNHCR-së dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare, si dhe nga pjesëtarët e OJF-ve.
2. Takimi realizohet në prani të personelit që merret me mbikëqyrjen.
3. Të huajve u sigurohet liria e korrespondencës (telefonike, telegrafike dhe postare), brenda dhe jashtë vendit. Tarifa e garantuar nga shteti shqiptar përcaktohet me urdhër të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Ministrisë së Financave, sipas programit ekonomik, duke përcaktuar kushtet përkatëse, ndërsa shpenzimi mbi këtë tarifë mbulohet nga vetë shtetasi.

KREU IV  
DETYRIMET E SHTETASVE NË QENDËR

Neni 14

**Përfaqësuesi i bashkësisë së shtetasve dhe detyrimet e shtetasve në Qendër**

Kriteret e caktimit të përfaqësuesit të bashkësisë së shtetasve dhe detyrimet e shtetasve në Qendër përcaktohen me rregullore të brendshme të Drejtorisë së Qendrës së pritjes dhe të trajtimit të përkohshëm të të huajve joazilkërkues.

KREU V  
LARGIMI OSE DËBIMI I SHTETASVE TË HUAJ

Neni 15

**Marrja e vendimit për largimin ose dëbimin e shtetasve të huaj**

1. Asnjë shtetas nuk largohet apo dëbohet nga territori i Republikës së Shqipërisë derisa të merret një vendim përfundimtar për kërkesën e tij/saj për ankim, mbështetur në nenet 48, 49, 51 dhe 52 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt".

2. Vendimi për largimin ose dëbimin e shtetasit të huaj merret në përputhje me nenet 4, 5, 46, 47, 52 dhe 54 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", si dhe të njoftimit me shkrim të bërë nga autoritetet përkatëse, nga organet gjyqësore dhe të administratës.

3. Miratimi i vendimit për largimin ose dëbimin bëhet nga autoriteti përgjegjës në Ministrinë e Rendit Publik.

4. Përpara se të huajt t'i njoftohet vendimi për largim ose dëbim, policia merr të gjitha masat e domosdoshme për mënyrën e kryerjes së largimit ose dëbimit, për mjetet e nevojshme, për sigurimin e vizave e të biletave të mundshme, si edhe për probleme të tjera.

5. I huaji mund t'i nënshtrohet ekzekutimit të menjëhershëm të një vendimi për largim, pavarësisht nga neni 56 (ankimi administrativ dhe gjyqësor) i ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt" ose të dëbohet për arsye garancie, në rastet e parashikuara në nenin 52 të këtij ligji.

6. Vendimi për largim ose dëbim pezullohet kur i huaji, brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit, paraqet arsye të bazuara se ky vendim përbën shkelje të marrëveshjeve apo të akteve ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë. Në këto raste, autoriteti në Ministrinë e Rendit Publik bën rishikimin e kërkesës të së huajit, brenda 8 ditëve nga data e paraqitjes së saj.

7. Personat, për të cilët vendimi për largim është dhënë me vendim të Ministrit të Rendit Publik për arsyet e përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", nuk kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë, përveçse për vendin e destinacionit.

8. Kërkesën për ankim shtetasi i huaj e paraqet te Drejtori i Qendrës, i cili e regjistron në regjistrin përkatës dhe i jep të huajit një vërtetim për marrjen e kërkesës. Drejtori i Qendrës i transmeton sekretarisë së subjektit juridik, administrativ apo gjykatës, procedurën e ankimit, të marrë nga i huaji, dhe vërtetimin që iu lëshua atij, brenda 24 orëve nga çasti i paraqitjes së ankesës.

9. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit të largimit bëhet deri në përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, vizës etj., si dhe deri në mbarimin e procedurës së ankimit, nëse i huaji e ka bërë atë brenda afateve e kushteve të përcaktuara në ligjin "Për të huajt". Shtyrja më tepër se 45 ditë e ekzekutimit të vendimit për largim bëhet vetëm me vendim të gjykatës, që shqyrton kërkesën e të huajit për rishikimin e vendimit.

10. Për çështjet e imigracionit, për të cilat bëhet ankim në gjykatë, zbatohen rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Megjithatë, për vetë karakterin e këtyre çështjeve, shqyrtimi në të gjitha shkallët e gjykimit nuk mund të zgjasë më shumë se 45 ditë (30 ditë gjykata e rrethit dhe 15 ditë gjykata e apelit).

KREU VI  
SHPENZIMET PËR KTHIMIN E TË HUAJVE

Neni 16  
**Llojet e shpenzimit**

Shpenzimet për kthimin e të huajit bëhen në përputhje me nenin 81 të ligjit "Për të huajt".

Neni 17  
**Burimet e sigurimit të shpenzimeve për largim ose dëbim**

Shpenzimet për largim ose dëbim policia i siguron nga bllokimi i të hollave ose i mjeteve të tjera të të huajit, sipas nenit 81 të ligjit "Për të huajt", nga Qendra ku i huaji është aktivizuar ose punësuar, nga shoqëritë ose personat transportues. Kur nuk ekzistojnë këto mundësi, shpenzimet financiare për largim ose dëbim të të huajit mbulohen nga Ministria e Rendit Publik.

**VENDIM**  
**Nr. 213, datë 16.11.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ““
Gjergji Sauli	Anëtar i ““
Alfred Karamuço	Anëtar i ““
Kristofor Peçi	Anëtar i ““
Kujtim Puto	Anëtar i ““
Sokol Sadushi	Anëtar i ““
Petrit Ploçi	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 16.11.2001, mori në shyrtime në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.178, Akti që i përket:

**KËRKUES:** GENCI MUHARREMI, përfaqësuar nga avokat Vasil Dode.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, marrë në Dhomën e Këshillimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, 134/g e 142/1 të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Rekursi i paraqitur në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, ky Kolegj nuk e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, por në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit.

Ky vendim i Kolegjit Penal vjen në kundërshtim me nenet 42/1 e 142/1 të Kushtetutës, sepse na ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në një proces të rregullt ligjor.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Ploçi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shyrtoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

Avokati Vasil Dode, në emër të të gjykuarit Genc Muharremi, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore rezultoi se avokati Vasil Dode, nuk është pajisur me prokurë nga ana e kërkuesit për ta përfaqësuar atë përpara Gjykatës Kushtetuese.

Në këto kushte, avokati nuk mund ta përfaqësojë atë e, për pasojë, nuk mund të paraqesë kërkesë në emër të tij.

Në këto rrethana duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

## V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## VENDIM

**Nr. 8, datë 23.1.2002**

## “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Tefta Zaka,	Anëtare e ““
Petrit Piloçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 12.12.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.190 Akti që i përket:

**KËRKUES:** ASTRIT BEJKO, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore.

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** ROBERT SINANI, përfaqësuar nga avokat Gjergji Hyso.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.410, datë 25.4.2001 e nr.3, datë 8.10.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e sipërcituara janë rezultat i zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Shkaqet e ngritura në rekursin kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë e të apelit janë ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile dhe Kolegji Civil duhet ta pranonte çështjen për shqyrtim dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit.

- Objekti i padisë nuk mund të jetë kthim sendi sipas nenit 296 të Kodit Civil, përderisa paditësi nuk është bërë pronar dhe pretendimi tjetër se Këshilli Bashkiak i Tiranës ka anuluar vendimin me të cilin i është hequr autorizimi, duke i dhënë përsëri të drejtën e strehimit, është i karakterit të pastër ligjor.

- Arsyetimi i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.3, datë 8.10.2001 mbështetet në thënie që nuk janë të vërteta. Bashkia e Tiranës (si organi kompetent), në asnjë rast, nuk ka kërkuar autorizim për paditësin Robert Sinani.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, me vendimin nr.1220, datë 25.4.2000, ka pranuar padinë e paditësit Robert Sinani ngritur kundër të paditurit Astrit Bejko me objekt kthim sendi, sipas neneve 296 e 298 të Kodit Civil dhe ka detyruar të paditurin t'i lirojë e dorëzojë banesën paditësit.

Mbi ankimin e të paditurit, Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.875, datë 3.12.2000, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.410, datë 25.4.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i padituri Astrit Bejko, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.3, datë 8.10.2001, në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e kërkesës së Astrit Bejkos për rishikimin e vendimeve të mësipërme me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile, etj.

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimi i Kolegjit Civil (Dhomës së Këshillimit) nr.410, datë 25.4.2001 është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së rrethit dhe të gjykatës së apelit, kërkuari Astrit Bejko ka parashtruar se subjekti i interesuar, Robert Sinani nuk legjitimohej për ngritjen e padisë së rivendikimit sipas nenit 296 të Kodit Civil, sepse duke mos qenë pronar nuk e ka regjistruar pronën në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se kontrata e subjektit të interesuar me Entin Kombëtar të Banesave është e kundërligjshme, përderisa ai nuk ka marrë autorizim nga bashkia, si organi kompetent që cakton radhën për strehim dhe se, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, ai duhet të ishte i pastrehë që të lidhte kontratë të ligjshme.

Pretendimet e mësipërme kanë të bëjnë si me mosrespektimin, ashtu dhe me zbatimin e ligjeve, të cilat nuk mund të shqyrtohen e të vendosen në Dhomën e Këshillimit pa praninë e Palëve, sepse u cenon këtyre të fundit të drejtën e pjesëmarrjes drejtpërdrejt në gjykim, si dhe të drejtën e mbrojtjes. Neni 472 i Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar rastet kur mund të ankimohen vendimet me rekurs në Gjykatën e Lartë. Në rastet kur rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, vendoset mospranimi i tij në Dhomën e Këshillimit. Pra, në këtë fazë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë bën vetëm verifikimin nëse janë ose jo shkaqet për rekurs, por nuk ka kompetencë të bëjë vlerësimin nëse janë apo jo të drejta pretendimet për mosrespektimin apo zbatimin e ligjit, sepse këto janë kompetenca të kolegjeve në seancë gjyqësore.

Nga ana tjetër, veprimtaria e Kolegjit Civil në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes nuk mund të jetë vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs.

Në rastet kur Kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e bindjen e brendshme të gjykatave të hallkave më të ulta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin.

Kjo është kompetencë e vetë Kolegjit. Por në rastin në gjykim problemi është ndryshe. Në rekursin e paraqitur nga kërkuesi nuk kontestohen provat, e as vlerësimi i tyre, por ngrihet problemi i legjitimit të paditësit, për shkak të bazës ligjore të padisë në dispozitat e Kodit Civil, si dhe probleme për përcaktimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave që duhen zbatuar në rastin konkret, etj. Vlerësimi i këtyre problemeve nuk është kompetencë e Dhomës së Këshillimit, por e Kolegjit Civil në seancë gjyqësore, ku duhet t'i jepet përgjigje e arsyetuar dhe të jepet zgjidhje në një nga mënyrat e parashikuara në nenin 485 të Kodit të Procedurës Civile.

Me pranimin nga Gjykata Kushtetuese të kërkesës për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë vendoset edhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në atë Kolegj. Në këtë mënyrë, mbetet pa objekt vendimi nr.3, datë 8.10.2001 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin nuk është pranuar kërkesa e kërkuesit, Astrit Bejko për rishikimin e vendimeve të gjykatës së rrethit, të apelit të Dhomës së Këshillimit të Kolegjit Civil. Duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë, edhe ky vendim duhet shfuqizuar. Është Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë që do të vendosë nëse do të lihen në fuqi, do të prishen etj. vendimet e hallkave më të ulta gjyqësore dhe, në varësi të këtij qëndrimi, kërkuesi do të vlerësojë nëse do të bëjë përsëri kërkesë për rishikim në atë gjykatë.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin e datës 30.10.2001, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për lirim dhe dorëzimin e banesës. Gjatë gjyqimit në Gjykatën Kushtetuese u konstatua se ato vendime janë ekzekutuar një ditë para se të merrej vendimi i pezullimit. Si rrjedhojë, vendimi i pezullimit duhet revokuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash

#### V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) nr.410, datë 25.4.2001 e nr.3, datë 8.10.2001.
- Revokimin e vendimit të pezullimit të ekzekutimit datë 30.10.2001 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
- Dërgimin e çështjes Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### VENDIM

**Nr. 18, datë 1.2.2002**

#### **“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Tefta Zaka,	Anëtare e ““
Petrit Piloçi,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 5.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.164/2 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Shoqëria “Pegaso”, përfaqësuar nga avokat Trifon Toska.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, përfaqësuar nga Fredi Meta.

2. Drejtoria e Tatim-Taksave Tiranë, përfaqësuar nga Margit Haxhihyseni.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.607, datë 14.6.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar si shkaqe:

- Shqyrtimi administrativ i ankimit pas pagimit të detyrimit tatimor shtrihet në raportet e kërkuesit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim-Taksave dhe jo në raportet me gjykatën.

- Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes, i cili sjell në mënyrë të pashmangshme shuarjen e padisë.

- Rivlerësimi nga ana e Gjykatës së Lartë i provave të administruara në gjykatat e tjera nuk është atribut i saj e, për pasojë, ajo ka zhvilluar një proces të parregullt.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### V Ë R E N:

Në muajin korrik 1998 Dega e Tatim-Taksave në Tiranë ka ushtruar kontroll në shoqërinë “Pegaso”, që merret me aktivitet ndërtimi dhe ka konstatuar se, përgjithësisht, nuk ka pasur shkelje, e veçanërisht në përllogaritjen dhe arkëtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, duke e konsideruar kontrollin e degës në këtë shoqëri si joreal, ka shqyrtuar vlerësimin tatimor duke e detyruar shoqërinë “Pegaso”, sipas akt-kontrollit të datës 14.8.1998, që të pagujë 6.114.564 lekë si TVSH e pallogaritur. Po në datën 14.8.1998, Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave ka lënë në shoqëri një akt-kontroll tjetër ku TVSH-ja e pallogaritur dhe papaguar rivlerësohej në 17.473.090 lekësh.

Në datat 17 dhe 28 gusht 1998 shoqëria paraqet ankim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim-Taksave ndaj rivlerësimit tatimor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, në datën 11.9.1998, me shkresën nr.3953/2, njofton se ankimi i shoqërisë nuk merrej parasysh. Më pas, në datën 5.12.1998 dega e Tatim-Taksave në Tiranë, me shkresën 3942/1 njofton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave ka shqyrtuar ankimin dhe nuk e ka marrë parasysh, prandaj shoqëria detyrohet të paguajë menjëherë shumën prej 17.736. 409 lekë.

Aktin e mësipërm shoqëria e ka kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila, me vendimin nr.1507, datë 12.5.1999 e ka shfuqizuar, bazuar në nenet 323 e 328 të Kodit të Procedurës Civile. Këtë vendim e ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.230, datë 8.3.2000.

Me rekursin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen dhe, me vendimin nr.607, datë 14.6.2001, ka vendosur: “Prishjen e të dy vendimeve të gjykatave dhe pushimin e gjykimit të çështjes”.

Gjykata Kushtetuese vëren se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi jo të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, është bazuar kryesisht në nenet 41 e 42 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, nga del se personi i tatueshëm duhet të paguajë TVSH-në, pavarësisht nëse ka kërkuar shqyrtimin apo është ankuar kundër vlerësimit tatimor.

Për më tepër, këto dispozita përcaktojnë detyrimin e Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave) që të mos shqyrtojnë ankimin e personave pa u paguar më parë nga ata gjithë TVSH-ja e përlogaritur dhe e pagueshme prej tyre.

Gjykata e Lartë, në shqyrtimin e çështjes dhe vendimin e saj, nuk ka marrë në konsideratë faktin se dispozitat ligjore ku mbështetet kushtëzojnë dhe kufizojnë të drejtën e ankimit. Ky fakt nuk mund të anashkalohej nga Gjykata Kushtetuese, edhe pse ato (dispozitat) kanë pasur ndryshime e përmirësime në këto drejtime. Bazuar sa më sipër, Gjykata e Lartë arsyeton se pala paditëse, shoqëria “Pegaso” duhej të kishte paguar TVSH-në, pavarësisht nëse ka kërkuar rivlerësim apo është ankuar ndaj vlerësimit tatimor. “Vetëm pasi të ketë përmbushur këtë detyrim – shprehet Gjykata e Lartë - dhe pasi të ishte njoftuar me shkrim nga ana e Ministrisë së Financave për rezultatin e rishqyrtimit...ajo (shoqëria) duhej të ishte drejtuar në gjykatë”.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se nenet 41 e 42 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” rregullojnë marrëdhëniet midis subjekteve të tatueshëm dhe organeve tatimore në lidhje me vlerësimin e tatimeve dhe rishqyrtimin e vlerësimit tatimor. Gjykata e Lartë nuk ka për objekt shqyrtimin e faktit, nëse këto marrëdhënie janë kryer konform kërkesave të dispozitave të mësipërme, pra të verifikojë nëse është bërë ankim ose jo, nëse është paguar detyrimi tatimor ose jo. Gjykata, kur i paraqitet ankimi nga subjekti tatimor, shqyrton nëse është nxjerrë rezultati i rishqyrtimit dhe pastaj i hyn themelit të ankimit.

Në rastin konkret, nga dokumentet e ndodhura në dosje, del e provuar plotësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave ka konfirmuar rezultatin e vlerësimit tatimor, gjë që vërteton se ka bërë rishqyrtim. Kundër aktit të këtij rivlerësimi, paditësi ka bërë padi në gjykatë dhe kjo e fundit nuk mund të pengohet të shqyrtohej çështjen në themel, thjesht për faktin se rivlerësimi është bërë pa u paguar detyrimi tatimor. Gjykata e Lartë, duke arsyetuar si më lart, padrejtësisht, ka shtrirë raportet e subjektit me organin administrativ në raportet procedurale-civile midis saj dhe paditësit.

Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit në një kohë kur kanë kaluar afatet e ankimit administrativ dhe afati i ankimit gjyqësor, parashikuar nga nenet 42 e 43 të ligjit “Për tatimin e vlerës së shtuar”. Në këtë mënyrë, paditësi është vënë plotësisht në pamundësi për të ushtruar të drejtën kushtetuese të ankimit në gjykatë, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Sipas vendimit, duke iu referuar edhe dispozitave ligjore të lartpërmendura, me “pushimin e gjykimit”, pala paditëse nuk mund të ngrejë padi në gjykatë, duke sjellë si pasojë të pashmangshme “shuarjen e padisë” në kundërshtim edhe me nenin 300 të Kodit të Procedurës Civile.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese e gjen vendimin nr.607, datë 14.6.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë antikushtetues, rezultat i një procesi të parregullt, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës.

Ashtu siç u analizua më lart antikushtetueshmëria e këtij vendimi lidhet së pari, me shtrirjen e procedurave që zbatojnë organet e administratës në veprimtarinë gjyqësore dhe së dyti, në mohimin në mënyrë të kundërligjshme të së drejtës për të ngritur padi.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/1f e 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.607, datë 14.6.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhej të ishte rrëzuar, për arsye se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe marrja e vendimit përkatës është në përputhje me ligjet në fuqi dhe nuk ka asnjë element të procesit të parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

1. Fakti që Gjykata e Lartë e ka mbështetur vendimin e saj në një dispozitë ligjore, për të cilën kërkuesi pretendon se është antikushtetues, nuk do të thotë apriori se ka zhvilluar një proces të parregullt. Kur gjykon një çështje konkrete, çdo gjykatë është e detyruar të zbatojë ligjin që ka lidhje me të. Detyrimi për të mos e zbatuar ligjin është vetëm në kushtet e nenit 145 të Kushtetutës, kur çmohet se ai vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Por, në rastin konkret, gjykata nuk ka bërë një vlerësim të tillë. Përkundrazi, ajo ka çmuar se ligji është në pajtim me Kushtetutën dhe e ka zbatuar atë. Qëllimi i dispozitës kushtetuese është se kur gjykata çmon se ligji është antikushtetues dhe bëhet pengesë për zgjidhjen e çështjes, gjykimi duhet të pezullohet dhe çështja t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar proces të parregullt, por ka zbatuar ligjin dhe dispozitat e Kushtetutës, prandaj vendimi i saj nuk mund të shfuqizohet si antikushtetues.

2. Në shqyrtimin e kësaj çështje duhet të bëhet mirë dallimi ndërmjet procesit të parregullt dhe pakushtetueshmërisë së ligjit. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është drejtuar për proces të parregullt dhe të tillë, sipas arsyetimit të mësipërm, nuk ka. Kjo mjafton që kërkesa të rrëzohet si e pabazuar. Përmbajtja e neneve 41 e 42 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" është një problem tjetër, që duhet të zgjidhet mbi bazën e një kërkesë që mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 131/a të Kushtetutës për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Sa kohë që një kërkesë e tillë nuk është bërë, duke u bazuar në një kërkesë për proces të parregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese nuk mund të shprehet për përmbajtjen e këtyre dispozitave.

3. Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i bazuar dhe nuk mund të shfuqizohet si antikushtetues edhe për arsyen tjetër që lidhet me zbatimin e ligjit, për të cilin ka çmuar se është në pajtim me Kushtetutën. Kështu, ky Kolegj, duke iu referuar dispozitave ligjore, konstaton se shoqëria "Pegaso" nuk ka zbatuar detyrimet e caktuara për procedurën e paraqitjes së ankimit dhe rishqyrtimit. Moszbatimi i këtyre detyrimeve ligjore nuk i jep të drejtë ankuesit të ankohet në gjykatë pa përfunduar më parë procedura e ankimit në rrugë administrative. Vënia në dukje e kësaj shkeljeje të ligjit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, jo vetëm nuk përbën shkelje, siç është trajtuar pa të drejtë, por përkundrazi është një detyrë e rëndësishme e Gjykatës, e cila zbaton ligjin në shqyrtimin e çështjes konkrete.

ANËTAR  
K. Peçi

## MENDIMI I PAKICËS

Në çështjen me kërkuar shoqëria "Pegaso" jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës për arsyet që vijnë:

Kërkuar ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se është rezultat i në procesi jo të rregullt ligjor.

Nisur nga motivimi që i ka bërë vendimit të tij Kolegji Civil, mendoj se nuk ka elementë të procesit jo të rregullt ligjor. Çështja që u është paraqitur për shqyrtim gjykatave ka të bëjë me një konflikt administrativ, shqyrtimi i të cilit bëhet duke respektuar edhe rregullat e vendosura në nenet 324-333 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas nenit 328 të këtij Kodi, si rregull, gjykatat e zakonshme bëhen kompetente për shqyrtimin e këtyre konflikteve pas shqyrtimit të çështjes në rrugë administrative. Edhe në rastin në shqyrtim, Kolegji Civil ka shqyrtuar çështjen nëse është eazuruar procedura administrative e zgjidhjes së konfliktit, dhe ka konkluduar se kjo procedurë nuk kishte përfunduar. Në këto rrethana, me të drejtë, Kolegji Civil ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Kjo çështje, pra, nëse ishte eazuruar rruga administrative e zgjidhjes së konfliktit, është një çështje fakti, që mund të merret në shqyrtim vetëm nga gjykatat e zakonshme e jo nga Gjykata Kushtetuese.

Kjo do të thotë, se në rast se Kolegji Civil ka pranuar se rruga administrave e zgjidhjes së konfliktit nuk ka përfunduar, kjo Gjykatë nuk mund ta vërë në dyshim këtë përfundim dhe të nxjerrë një konkluzion të kundërt. Të mbash qëndrim të kundërt do të thotë të marrësh kompetencat e gjykatave të sistemit të drejtësisë.

Përveç kësaj, kërkuesi në seancë gjyqësore nuk arriti të provonte shkelje të parimeve themelore për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuara në Kushtetutë.

ANËTAR  
P.Pilloci

**VENDIM**  
**Nr. 20, datë 8.2.2002**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergji Sauli,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Petrit Pilloçi,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 23.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen me nr.192/6 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** BAUDIN MELANI, përfaqësuar nga av.Liljana Ruli, me prokurë.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1.PETRO PINO, përfaqësuar nga av.Perikli Kolagji, me deklaram.

2. ENTI I BANESAVE SARANDË, në mungesë.

3. BASHKIA E QYTETIT, SARANDË, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.351, datë 5.10.1999 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr.1508, datë 22.12.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.B-3, datë 24.7.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e Apelit nuk ka vënë në diskutim nëse për dhënien e autorizimit për banesën ishte kompetent Këshilli Bashkiak i Qytetit – Sarandë apo Komisioni i Strehimit të degës së SHIK-Sarandë.

- Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre lidhur me pretendimet e kërkuesit.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Petrit Pilloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit të Sarandës, me vendimin nr.334, datë 6.7.1998, ka rrëzuar padinë e Petro Pinos, e cila kishte për objekt pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes (privatizimit) të një apartamenti, nga ana e të paditurit Baudin Melani, apartament i cili ndodhet në qytetin e Sarandës.

Gjykata e Apelit të Gjirokastrës, me vendimin nr.351, datë 5.10.1999, ka prishur vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit të Sarandës dhe duke e gjykuar çështjen, në fakt, ka pranuar padinë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e Baudin Melanit, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.1508, datë 22.12.2000, ka vendosur mospranimin e këtij rekursi, si të pabazuar në ligj.

Kërkuesi, në bazë të nenit 473 të ndryshuar të Kodit të Procedurës Civile, ka paraqitur rekurs në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kolegji Seleksionues i këtyre Kolegjeve, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.B-3, datë 24.7.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj.

Në këto kushte, Baudin Melani, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme të gjykatave, duke pretenduar se këto vendime janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor.

Nga shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit nuk rezultojnë të bazuara.

Konkretisht, si element të një procesi jo të rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur, kërkesi ka përmendur atë se gjykata e apelit nuk ka vënë në bisedim nëse, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 9.1.1995 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.530, datë 17.10.1994” që trajton mënyrën e ndarjes së banesave, dhënia e autorizimit për strehim ishte në kompetencë të Këshillit Bashkiak të Qytetit të Sarandës apo të Komisionit të Strehimit të Degës së SHIK-ut, Sarandë. Për këtë çështje, Gjykata Kushtetuese vëren se interpretimi i akteve normative, siç është edhe vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave, është kompetencë e gjykatës që shqyrton çështjen. Gjykata Kushtetuese ka kompetencë të shqyrtojë vendimet e gjykatave vetëm kur ato bien në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës që sanksionojnë parimet themelore për një proces të rregullt ligjor.

Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se si Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre pretendimet e kërkuesit. Edhe në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton elementë të procesit jo të rregullt ligjor. Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues kanë arsyetuar në vendimet e tyre lidhur me mospranimet e rekursit. Fakti se këto gjykata kanë arsyetuar në mënyrë të përmbledhur nuk përbën shkelje në aspektin kushtetues.

Përsa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Baudin Melani duhet të rrëzohet.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/f të Kushtetutës dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.1 të vitit 2002, vendimi nr.6, datë 18.1.2002 i Gjykatës Kushtetuese,  
në faqen 9, rreshti nr.16:  
është neni 96 pika 3;  
bëhet neni 87 pika 3.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 19.2.2002  
Doli nga shtypi më 21.2.2002

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Edlor”  
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë